REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 4048/1 Prot.

Lushnje më, 14/05/2025

PROJEKT-VENDIM

NR. 44 DATË 14/05/2025

"PËR MIRATIMIN E PRISHJES SË OBJEKTIT EGZISTUES NË PASURINË NR. 58/37, ZK. 1975, ME EMËRTIM NË INVENTAR SHKOLLË E MESME, FSHATI HYSGJOKAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE HYSGJOKAJ, BASHKIA LUSHNJE DHE RINDËRTIMI I OBJEKTIT ME EMËRTIM SHKOLLË E MESME NË TË NJËJTËN PASURI."

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ____/____/2025, në mbështetje të nenit 9 pika 1.2/a/c dhe neni 54, gërma "e", pika 1 të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 4, nenit 5, pika 1.3, gërma a, nenit 12, nenit 22 të ligjit nr.107 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, VKM-së nr. 319 datë 12.04.2017 "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave", dhe VKM-së nr. 573 datë 23.08.2006 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Hysgjokaj, të Qarkut të Fierit", me kërkesë të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit:

PROPOZOJMË:

I. Të miratoj prishjen e objektit egzistues të ndodhur në pasurinë nr. 58/37, me emërtim në inventar "Shkollë e Mesme", me sipërfaqe 360 m^2, ZK. 1975, fshati Hysgjokaj, Njësia Administrative Hysgjokaj, Bashkia Lushnje.

II. Rindërtimin e objektit të "Shkollës se Mesme" fshati Hysgjokaj, në pasurinë nr. 58/37, ZK. 1975, fshati Hysgjokaj, 2 kate, sheshi i ndërtimit për objektin është 4125 m^2, sipërfaqja e katit përdhe të objektit të ri është 598 m^2.

III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Lushnje.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT

Mimoza Haxhiu

DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 573 **, datë** 23.8.2006

PËR

MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS HYSGJOKAJ, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore (lidhja 1), që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Hysgjokaj, të qarkut të Fierit, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

   Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Hysgjokaj, të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.130, datë 11.3.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Hysgjokaj".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Hysgjokaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM

SOKOL OLLDASHI

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
2-5;15-18;	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
6	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive kulturore .	Në pronësi
19,20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
43,44,45,46,47,48,49,50,51 ,52,53,54,55,56,57-78	Zhvillim ekonomik	Në pronësi
79	Infrastrukture (troje të lira)	Ne Përdorim
90,91,92,93,94,95,96,97,98 ,99	Infrastrukture (troje, rruge vendore)	Në pronësi
80-88	Sherbim funeral	Në pronësi
7-14	Mbrojtje civile	Në pronësi
100-123,	Shërbim publik (furnizimi me ujë)	Në pronësi
29,31,32,33,36,38,	Prona që perdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
27,28,30,	Prona që perdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në Përdorim

NR.PROT.2677/1
DATË 24.8.2006

PRESIDENCËS
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRISË SË MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE
AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE
QARKUT TË FIERIT
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Myqerem TAFAJ

Sekretar i Përgjithshëm

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
2			Truall ndertese	Shkolle e mesme Fshati Hysgjokaj Komuna Hysgjokaj	4125	360	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Arsimore Lushjne	Brenda nderteses se shkolles ndodhet kopshti I femijeve 16m2

8947
31.10.2024.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA LUSHNJE

NJESIA ADMINISTRATIVE HYSGJOKAJ

Nr.586 Prot

Hysgjokaj me 31/10/2024

Lenda : Informacion

Drejtuar: ZYRËS SË URBANISTIKËS

BASHKIA LUSHNJE

Informacion mbi Shkollen e Mesme te Bashkuar Zyber Sharka Hysgjokaj, Pasuria nr 58/37, Indeksi I hartes K-34-112-(026-A), Siperfaqe totale 4,125.00.

ADMINISTRATORI

HYSNI DINGOZI

Adresa:Lagja "Kongresi" Tel/Fax:+355 35 22 139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com



NR PASURIE 58/37

2316
10.03.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LUSHNJË
SHKOLLA E MESME E BASHKUAR "ZYBER SHARKA" HYSGJOKAJ

Nr. 415 Prot Hysgjokaj më 05.03.2025

LËNDA: INFORMACION PER GJENDJEN E GODINËS EKZISTUESE DHE KËRKESË PËR NDËRTIMIN E NJË SHKOLLE TË RE .

DREJTUAR: BASHKISË LUSHNJE, ZYRES SE URBANISTIKES PRANE BASHKISË LUSHNJE, QËNDRËS ARSIMORE PRANË BASHKISË LUSHNJE

Shkolla e Mesme e Bashkuar "Zyber Sharka" ka ne perberje te saj tre shkolla vartese te arsimit fillor dhe shkolla qender (e Mesme e Bashkuar)
Godinat e shkollave vartese jane ne gjendje te mire persa i perket infrastruktures se tyre dhe nuk kerkojne nderhyrje te medha me perjashtim te disa sherbimeve te vogla si lyerje dhe meremetime te dyerve apo dritareve.
Godina e shkolles qender ndodhet ne gjendje te keqe pasi ka pesuar demtime nga goditjet e termeteve te fundit ne strukture sipas vezhgimit te personave te specializuar.
Kjo kerkon ndertimin e nje godine te re e cila duhet te permbushe te gjitha kekesat persa I perket sistemit te ngrohjes, sistemit hidraulik, sistemit sanitar, sistemit elektrik, terreneve sportive, si dhe pajisja me laboratore e kabinete sipas lendeve te caktuara.
Nga ana jone, jane bere kerkesa vitet e kaluara per disa problematika prane njesise administrative dhe bashkise Lushnje. Keto jane pranuar si te nevojshme nga keto institucione.

Nga Bashkia Lushnje jane paraqitur opsioni I rikonstruksionit te pegjithshem te godines aktuale dhe ndertimi I nje godine te re.
Nisur nga problematikat e menjehershme, dhe nevojat e meposhtme, kolektivi I mesuesve te shkolles komuniteti I prinderve dhe perfaqesuesit te qeverise se nxenesve kerkon nga Bashkia Lushnje ndertimin e nje godine te re. Me poshte po listojme problematikat dhe nevojat se pse duhet nje godine e re.

1. Themelet jane shume te amotizuara si rezultat I futjes se ujit per nje kohe te gjate ne to.
2. Ne kete godine mungojne kolonat antisizmike duke ulur shume sigurine nga lekundje te tilla.
3. Dyshemeja e katit te pare nga ana jug-perendimore eshte ulur disa cm.
4. Muret e te dy kateve jane te çara(ne strukture) sidomos ato te anes jug-perendimore.
5. Soletat e te dy kateve jane shume te amortizuara.
6 . Çatia gjithashtu e amortizuar dhe fut uje gjate shirave, mungojne dhe ulluqet.
7 . Lartesia nga toka e godines eshte e vogel gje e cila shkakton shume lageshti dhe myk ne katet e para.
8 . Pozicioni I hyrjes se godines eshte I papershtashmem (me pamje nga veriu) gje qe ben te mos kete prani te diellit gjate gjithe kohes se qendrimit te nxenesve dhe mesuesve ne shkolle.
9. Nuk ka shkalle emergjence

. Ne te ardhmen shkollat vartese mund te vijne te zhvillojne mesimin ne kete godine dhe numri aktual I njediseve nuk mjafton (aktualisht jane 14 klasa mesimore dhe 4 anekse te cilat nuk jane funksionale pasi nuk plotesojne kushtet, kerkohen te pakten 22 ambjente)

NEVOJAT PER AMBJENTE NE SHMB "ZYBER SHARKA" HYSGJOKAJ

Nxenes gjithsej si SHMB per vitin shkollor 2024-2025 = 220 nxenes
Femije ne kopshte per vitin shkollor 204-2025 = 46 femije

1 . ARSIMI FILLOR KL.1-5 = 5 Ambjente
2 . ARSIMI I MESEM I ULET KL.6-9 = 4 Ambjente
3 . ARSIMI I MESEM I LARTE KL. 10-12 = 3 Ambjente
4 . ARSIMI PARASHKOLLOR = 1 Ambjent
5 . BIBLIOTEKE = 1 Ambjent
6 . SALLE PER MESUESIT = 1 Ambjent
7 . KABINET INFORMATIKE = 1 Ambjent
8 . DREJTORI = 1 Ambjent
9 . DHOME MJEKU = 1 Ambjent
10 . DHOME E EDUKIMIT FIZIK = 1 Ambjent
11 . DHOME E PSIKOLOGUT = 1 Ambjent
12 . DHOMA E SANITARES = 1 Ambjent
13 . MAGAZINE PER SHKOLLEN = 1 Ambjent
14. NYJE HIGJENO-SANITARE.

Gjithsej kerkohen 22 ambjente.

Kerkesa eshte firmosur si me poshte nga kolektivi I mesuesve te shkolles qender, keshilli I prinderve dhe perfaqesuesit te qeverise se nxenesve

Nr	Emër	Mbiemër	Funksioni	Nenshkrimi
1	Ramis	Xhebexhiu	Drejtor AML	
2	Artiola	Loshe	Nendrejtor AMU	
3	Ardjan	Sulko	Mesues AML	
4	Erion	Korreshi	Mesues AML	
5	Genci	Xhebexhiu	Mesues AML	
6	Kastriot	Nushi	Mesues AML	
7	Lirim	Sulko	Mesues AML	
8	Ritvana	Çela	Mesues AML	
9	Adriana	Librazhdi	Mesues AMU	
10	Anila	Sharka	Mesues AMU	
11	Artur	Leka	Mesues AML	
12	Atlet	Bali	Mesues AMU	
13	Bikjola	Topi	Mesues AMU	
14	Dhurata	Sulko	Mesues AMU	

15	Edlira	Leka	Mesues AMU	
16	Gerti	Berberi	Mesues AMU	
17	Liljana	Xhebexhiu	Mesues AMU	
18	Raimonda	Cani	Mesues AMU	
19	Alketa	Xhebexhiu	Mesues AF	
20	Esma	Sharka	Mesues AF	
21	Lumturi	Sina	Mesues AF	
22	Ana	Sharka	Mesues AF	
23	Vangjush	Knuti	Mesues AF	
24	Kreshnik	Caka	Mesues AF	
25	Blerina	Shore	Psikologe e shkolles	
26	Samanta	Tabaku	Keyetar i qeverise se nxenesve	
27	Artur	Toska	Kryetar i keshillit te prinderve	
28	Ardian	Xhebexhiu	Kryetar I bordit te shkolles	

DREJTORI I SHKOLLES
RAMIS XHEBEXHIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 2174 Prot.

Datë 22.4.2025

URDHËR

Nr. 132, datë 02.04.2025

PËR

PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË REJA, ME CIKËL FINANCIMI 2025-2026, NGA PROGRAMET "ARSIMI BAZË", "ARSIMI I MESËM" DHE PROGRAMI "PËR SPORTIN", PËR INFRASTRUKTURËN SHKOLLORE E SPORTIVE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 15, pika 11, të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimit nr. 9, datë 27.04.2022 "Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin/bashkëfinancimin e projekteve për përmirësimin e të infrastrukturës shkollore dhe sportive", si dhe Urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

URDHËROJ :

1. Miratimin e projekteve të reja, me cikël financimi 2025-2026, thirrja e parë, të cilat financohen nga programet buxhetore "Arsimi bazë", "Arsimi i mesëm" dhe programi "Për Sportin".
2. Masa e financimit nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin, për periudhën afatmesme 2025-2027, si dhe pjesa takuese e bashkëfinancimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, është sipas tabelës bashkëlidhur.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, projektet e të cilëve janë shpallur fituese, njoftohen zyrtarisht për marrjen e masave për realizimin e procedurave të prokurimit dhe angazhimin në buxhetin e vitit 2025 të pjesës takuese të bashkëfinancimit
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTËR

Orjana Osmani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT · TIRANË

Tabela 1. Lista e projekteve me cikël financimi për periudhën afatmesme 2025-2027.

Nr	NJQV	Emërtimi i Projektit	Vlera e plotë e projekit	Kontributi në financim nga NJQV	Financimi ne lekë (Viti 2025) MAS+NJQV	Financimi i MAS per vitin 2025	Financimi ne le (viti 2026-2027
1	Lushnjë	Rindërtimi i shkollës së mesme të bashkuar "Zyber Sharka", fshati Hysgjokaj	83.554.643	**16,710,929**	16.710.929	13.368.743	50.132.786

